


MATEMATIKA E APLIKUAR PËR OPERATORËT E TRAJTIMIT TË UJIT

Përshkrimi i kursit

Përpara se uji i pijshëm të shpërndahet te konsumatorët, operatorët e shoqërive UK duhet të mundësojnë ujë me cilësi të pranueshme dhe të standartizuar, nëpërmjet trajtimit të tij. Për të arritur këtë cilësi në një mënyrë sa më eficiente, operatorët e shoqërive UK duhet të njohin veprimet dhe llogaritjet matematikore që shoqërojnë proceset e trajtimit të ujit.



Pjesëmarrësit në këtë kurs do të thellojnë njohuritë e tyre në konceptet e hidraulikës, llogaritjet e fuqisë së pompave dhe eficientës së tyre, llogaritjet që shoqërojnë proceset e koagulimit, flokulimit, sedimentimit, filtrimit dhe dezinfektimit. Gjithashtu operatorët do të marrin njohuri për llogaritjen e fortësisë së ujit dhe zbutjen e tij.

Kush duhet të marrë pjesë

Ky kurs është hartuar për profesionistët e shoqërive ujësjellës kanalizime detyrat e të cilëve përfshijnë projektimin e impianteve të trajtimit të ujit të pijshëm, trajtimin dhe shpërndarjen e ujit, si dhe për laborantët të cilët monitorojnë cilësinë e ujit në dalje të impianteve dhe në rrjetin shpërndarës.

Objektivat e kursit të trajnimit

Në fund të këtij kursi trajnimi, ju do të jeni të aftë të:

- Llogarisni parametrat e ujit si, presionin, presioni manometrik dhe shkarkimin;
- Vlerësoni fuqinë dhe eficientën e pompave;
- Kryeni llogaritjet për burimin e ujit, rënien e nivelit të ujit, presionin, rendimentin, prodhimin specifik;
- Llogarisni heqjen e hekurit dhe manganit;
- Kryeni llogaritjet e koagulimit dhe flokulimit;
- Kryeni llogaritjet e kalibrimin për ushqyesit e tretësirave kimike dhe kimikateve të thata;
- Llogarisni prurjen dhe normën e filtrimit;
- Përcaktoni dozën, kërkesën dhe mbetjet e klorit;
- Llogarisni kalciumin, magnezin, si dhe fortësinë karbonatike dhe jo karbonatike.

Metoda e trajnimit

Trajnimi është i bazuar në leksione të prezantuara në Power Point, të ndërthura me diskutime dhe raste studimore. Përveç marrjes së leksioneve dhe diskutimeve, pjesëmarrësit do të analizojnë edhe raste konkrete studimore.

Materialet e kursit të trajnimit

Si pjesëmarrës në këtë kurs, ju do të pajiseni me Manualin e Trajnimit "Matematika e Aplikuar për Operatorët e Trajtimit të Ujit". Përpos kësaj, ju do të pajiseni me certificate, e cila dëshmon pjesëmarrjen tuaj në këtë trajnim.

Tarifa e regjistrimit

Anëtarët e SHUKALB/SHUKOS: 13,000 lekë për person

Jo-anëtarët: 16,000 lekë për person

Kjo tarifë përfshin materialet e kursit, drekat, dhe pushimet për kafe.